

VENDIM
Nr. 421, datë 26.6.2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 325, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGAVE, NIVELEVE TË PAGAVE DHE SHTESAVE TË TJERA MBI PAGË TË ZËVENDËSMINISTRIT, FUNKSIONARËVE TË KABINETEVE, PREFEKTIT, NËNPREFEKTIT, NËPUNËSVE CIVILË DHE NËPUNËSVE NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE", TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", të shkronjës "h", të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, dhe të neneve 7 e 9, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të shkronjës "d", të pikës 1, të kreut I, shtohen emërtesat, si më poshtë vijon:

- a) Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror;
- b) Administrata (specialist) në qendrat burimore dhe shkollat me status të veçantë.

2. Lidhjet nr. 1, nr. 2, nr. 12, nr. 12/1, nr. 12/3, nr. 12/5 e nr. 12/6 zëvendësohen me lidhjet me të njëjtët numra dhe tituj, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

3. Pika 11/2, e kreut III, dhe lidhja 12/2 shfuqizohen.

4. Në lidhjen nr. 3 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"7. Në ministrinë përgjegjëse për financat:

a) në masën 24 000 (njëzet e katër mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet:

i. "drejtor i përgjithshëm" në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për çështjet e programimit makroekonomik dhe fiskal, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për politikën tatimore, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për çështjet rregullatore dhe përputhshmërinë dhe në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për borxhin;

ii. "drejtor drejtorie" në njësitë përgjegjëse për planifikimin dhe monitorimin e buxhetit qendror e vendor të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për çështjet e programimit makroekonomik dhe fiskal, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për politikën tatimore, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për borxhin dhe në drejtorinë përgjegjëse për programimin, standardizimin dhe harmonizimin e kuadrit rregullator.

b) në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj për nëpunësin në pozicionet:

i. "përgjegjës sektori" në njësitë përgjegjëse për planifikimin dhe monitorimin e buxhetit qendror e vendor të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit;

ii. "përgjegjës sektori" në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për çështjet e programimit makroekonomik dhe fiskal, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për borxhin, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për politikën tatimore dhe në drejtorinë përgjegjëse për programimin, standardizimin dhe harmonizimin e kuadrit rregullator.

c) në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj për nëpunësit në pozicionet:

i. “koordinator” dhe “specialist” në njësitë përgjegjëse për planifikimin dhe monitorimin e buxhetit qendror e vendor të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit;

ii. “specialist” në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për çështjet e programimit makroekonomik dhe fiskal, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për borxhin, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për politikën tatimore dhe në drejtorinë përgjegjëse për programimin, standardizimin dhe harmonizimin e kuadrit rregullator.

ç) në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj për nëpunësit në njësitë e tjera organizative të përmbajtjes.”.

b) Pas pikës 26 shtohet pika 27, me këtë përmbajtje:

“27. Në ministrinë përgjegjëse për ekonominë, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj për nëpunësit në pozicionet “drejtor i përgjithshëm”, “drejtor drejtorie”, “përgjegjës sektori” dhe “specialist” në:

a) drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për pronën shtetërore;

b) drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për çështjet e nxitjes së biznesit dhe të tregtisë;

c) drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për analizat ekonomike;

ç) drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për çështjet e punësimit;

d) drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për inovacionin;

dh) drejtorinë përgjegjëse për çështjet e strehimit.”.

5. Në lidhjen nr. 4:

a) në shkronjën “b”, pas fjalëve “përgjegjës sektori” shtohet “inspektor”;

b) pas shkronjës “j” shtohet shkronja “k”, me këtë përmbajtje:

“k) Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit – “specialist, vullat zyrtare”, përgjegjës për prodhimin fizik të vulave zyrtare për institucionet publike.”.

6. Në lidhjen nr. 8, pas fjalëve “Zëdhënës i ministrit.” shtohen “Koordinator në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike.”.

7. Në lidhjen nr. 11, shtohet rreshti, me këtë përmbajtje:

Specialist me funksione administrative në qendrat burimore dhe shkollat me status të veçantë.	IV-4	1, ose 2, ose 3
---	------	-----------------

II. Ngarkohen:

1. Departamenti i Administratës Publike për mbështetjen dhe sqarimin ndaj institucioneve, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, për zbatimin e klasave të pagave deri në momentin e miratimit të strukturave dhe organikave të reja;

2. Institucionet e administratës publike, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, të propozojnë deri më 20 korrik 2024, sipas legjislacionit në fuqi, ndryshimet në strukturat dhe në organikat ekzistuese të degëve territoriale për përshtatjen e tyre sipas klasave të pagave, të përcaktuara në këtë vendim.

III. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë, si më poshtë vijon:

1. Për përcaktimet e pikave 1, shkronja “b”, 4, 6 dhe 7, të kreut I, të këtij vendimi, nga data e emërimit/transferimit të nëpunësve në detyrë dhe për vitin 2024 përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion për këtë vit;

2. Për të gjitha përcaktimet e tjera, nga data 1 korrik 2024 dhe për vitin 2024, përballohen nga fondi i kontingjencës për rritjen e pagave, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 1

Kategoritë e klasat e pozicioneve të punës, si dhe vlerat mujore të shtesave të pozicioneve të nëpunësve civilë dhe nëpunësve të institucioneve të përcaktuara në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi, me përjashtim të punonjësve të përcaktuar në pikën 2, të kreut II

Kategoria	Klasa e pagës (pozicioneve të punës për secilën kategori)	Elementet e pagës bruto mujore, përjashtuar shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) dhe për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin, që jepen rast pas rasti sipas përcaktimit në këtë vendim		
		Paga për pozicion (lek në muaj)	Shtesa e nivelit të kualifikimit	Shtesa për vjetërsi (sipas mënyrës së llogaritjes së përcaktuar në shkronjën “ç”, të pikës 1, të kreut II)
<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>
E lartë drejtuese	I	I-1	235 000	1
		I-2	217 000	1
		I-3	205 000	1
		I-4	180 000	1
		I-5	170 000	1
E mesme drejtuese	II	II-1	155 000	1
		II-2	141 000	1
E ulët drejtuese	III	III-1	115 000	1
		III-2	105 000	1
		III-3	98 000	1
Ekzekutive	IV	IV-1	90 000	1 ose 2
		IV-2	80 000	1 ose 2, ose 3
		IV-3	70 000	1 ose 2, ose 3
		IV-4	60 000	1 ose 2, ose 3

Lidhja nr. 2

Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit

Grupi i diplomës	Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK)	Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit (lek/muaj)
1	Niveli 7 i KSHK (Master i shkencave. Master i arteve. Master Profesional të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	14 000
2	Niveli 7 i KSHK-së (Master profesional. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	12 000
3	Niveli 6 i KSHK-së (Bachelor. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	10 000

Lidhja nr. 12

Klasat e pagave të nëpunësve në pozicionet “specialist” deri në “titullar institucioni”, në degët territoriale të institucioneve të përcaktuara në shkronjat “a” deri në “d”, të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, të punonjësve që kryejnë funksione të deleguara të pushtetit qendror në pushtetin vendor, të drejtorive të ujitjes dhe të kullimit, administratave rajonale të zonave të mbrojtura, të komisioneve vendore të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, pranë prefektit të Qarkut, të nëpunësve civilë në pozicionet mbështetëse “specialist”, “shef seksioni” dhe “përgjegjës/shef

sektori”, në drejtoritë e policisë në qarqe, në komisariate dhe reparte autonome, si dhe të punonjësve civilë në qendrat e rekrutimit dhe mobilizimit dhe komandat e mbështetjes rajonale, të sistemit të Forcave të Armatosura

Pozicioni	Klasa e pagës	Grupi i diplomës
Titullar i institucionit rajonal. Drejtor i drejtorive të ujitjes dhe kullimit. Përgjegjës i degës së thesarit në qendër qaraku. Drejtor i drejtorive të administrimit dhe të mbrojtjes së tokës në qarqe.	III-1	1
Titullar i institucionit vendor. Drejtor i degës territoriale të Shërbimit të Provës. Përgjegjës sektori në degën e thesarit Tiranë. Përgjegjës të degëve të tjera vendore të thesarit. Drejtor drejtorie në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar. Përgjegjës sektori në institucionet rajonale. Përgjegjës sektori në drejtoritë e administrimit dhe të mbrojtjes së tokës në qarqe. Përgjegjës i zyrës vendore të punësimit në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Përgjegjës i zyrës rajonale. Përgjegjës sektori në drejtoritë e ujitjes dhe kullimit.	III-2	1
Përgjegjës sektori në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar. Përgjegjës i zyrës së gjendjes civile në bashki (si funksion i deleguar). Përgjegjës i gjendjes civile pranë prefektit. Përgjegjës sektori në institucionet/zyrat vendore.	III-3	1
Përgjegjës i zyrës së gjendjes civile në njësitë administrative (si funksion i deleguar). Përgjegjës i sektorit të financës dhe administrimit në Ofruesin e Arsimit dhe Formimit Profesional.	IV-1	1
Specialist në degën territoriale të Shërbimit të Provës. Specialist në njësitë teknike të përmbajtjes në drejtoritë rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Specialist në degët e thesarit. Specialist në degët rajonale të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit. Specialist në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar. Inspektorë të sistemit të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë. Specialist në zyrat rajonale të Avokatit të Popullit.	IV-2	1 ose 2, ose 3
Specialist i zyrës së gjendjes civile në bashki (si funksion i deleguar). Specialist në drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit. Specialist i gjendjes civile pranë prefektit. Specialist në institucionet rajonale. Specialist në zyrat vendore të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Specialist në Ofruesin e Arsimit dhe Formimit Profesional. Specialist në zyrat vendore të arsimit parauniversitar. Restaurator arti. Arkitekt. Inspektor. Specialist në degën territoriale të Shërbimit të Provës.	IV-3	1 ose 2, ose 3
Specialist në institucionet e tjera vendore. Specialist i zyrës së gjendjes civile në njësitë administrative (si funksion i deleguar). Restaurator. Instruktur. Piktor. Kontrollor pune. Specialist në degën territoriale të Shërbimit të Provës.	IV-4	1 ose 2, ose 3

Lidhja nr. 12/1

Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni” në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale

Pozicioni	Klasa e pagës	Grupi i diplomës	Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lek/muaj)
Titullar i institucionit.	II-2	1	10 000
Zëvendëstitullar i institucionit.	III-1	1	8 000
Përgjegjës sektori të shërbimit social.	III-2	1	6 000
Përgjegjës sektori.	III-3	1	5 000
Specialist i sektorit të shërbimit social/psikolog/punonjës social.	IV-1	1 ose 2	5 000
Specialist.	IV-3	1 ose 2, ose 3	4 000

Lidhja nr. 12/3

Klasat e pagave të nëpunësve civilë në pozicionet mbështetëse “specialist”, “shef seksioni” dhe “përgjegjës/shef sektori” në drejtoritë e policisë në qarqe, komisariate dhe reparte autonome

Pozicioni	Klasa e pagës	Grupi i diplomës
Përgjegjës/shef sektori në drejtoritë e policisë së qarkut.	III-2	1
Shef seksioni në drejtoritë e policisë së qarkut, komisariate, apo reparte autonome.	III-3	1
Specialist.	IV-3	1 ose 2, ose 3
	IV-4	1 ose 2, ose 3

Lidhja nr. 12/5

Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar i degës”, në degët rajonale të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor

Pozicioni	Klasa e pagës	Grupi i diplomës	Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lek/muaj)
Titullar i institucionit rajonal.	III-1	1	18 500
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes.	III-2	1	18 500
Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës.	III-3	1	0
Inspektor.	IV-3	1 ose 2, ose 3	18 500
Specialist në sektorët mbështetës.	IV-3	1 ose 2, ose 3	0

Lidhja nr. 12/6

Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar i zyrës përmbartimore vendore”, në zyrat përmbartimore vendore të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror

Pozicioni	Klasa e pagës	Grupi i diplomës	Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lek/muaj)
Titullar i zyrës.	II-1	1	15 000
Përgjegjës sektori.	III-3	1	0
Specialist.	IV-2	1 ose 2, ose 3	0